

# MARRËVESHJA PËR KONFIDENCIALITETIN NË LIDHJE ME INTERVISTËN E PUNËS

Kjo marrëveshje për ruajtjen e konfidencialitetit gjatë intervistës ["Marrëveshja"] bëhet efektive në datën [DATA],

**NDËRMJET:** [EMRI I PUNËMARRËSIT] ("Punëmarrësi"), një individ me venbanim në:  
[ADRESA E PLOTË]

**DHE:** [EMRI I KOMPANISË SUAJ] ("Kompania"), shoqëri tregtare që është themeluar dhe regjistruar në përputhje me legjislacionin shqiptar me zyrën e vet qendrore në adresën:  
[ADRESA JUAJ E PLOTË]

## KUSHTET

- Kompania është duke marrë në intervistë punëkërkuuesin për pozicionin e [POZICIONI] për të punuar në projektet e mëposhtëme: [PËRSHKRUANI]
- Punëkërkuesi e kupton që informacionet me natyrë sekret tregtar mund të bëhen të ditura për të, gjatë procesit të intervistimit, ose për shkak të hyrjes së punëkërkuesis në ambjentet e Kompanisë.
- Punëkërkuesi kupton dhe pranon që informacionet që përbëjnë sekret tregtar për Kompaninë përbledhin materialet që janë të vlefshme për Kompaninë dhe që përgjithësisht nuk janë të ditura për konkurrentët e Kompanisë. Informacionet që përbëjnë sekret tregtar të kompanisë janë:
  - Çdo lloj informacioni dhe të gjitha informacionet e Kompanisë mbi produktet, aktuale dhe të ardhshme, që përfshijnë, por pa u kufizuar në to: kodet kompjuterike të papublikuara (si kodet burimore, ashtu edhe kodet e produktit), skicat, specifikimet, hyrjet në regjistra, shënimet teknike, apo grafikët, dokumentet kompjuterike të shtypura, memorandumet teknike apo korrespondenca, marrëveshjet për zhvillimin e produktit dhe marrëveshje të tjera të lidhura me këtë.
  - Informacionet dhe materialet që lidhen me blerjet, kontabilitetin dhe marketing-un e Kompanisë, por pa u kufizuar në to: planet e marketing-ut, të dhënat e shitjeve, materiale promociionale jo të publikuara, informacione mbi koston dhe çmimet si dhe listat e klientëve.
  - Informacioni i tipit të përshkruar më lart, të cilin Kompania e ka përfituar nga palë të treta, dhe që Kompania e trajton si konfidencial, pavarësisht nëse është në pronësi të Kompanisë, apo i përpunuar nga Kompania.
- Në të gjitha rastet, gjatë kësaj interviste, Punëkërkuesi do t'i trajtojë si konfidenciale dhe nuk do t'i përdorë apo t'ia bëjë të ditur një palë të tretë asnjë prej sekreteve tregtare të Kompanisë.
- Punëkërkuesi nuk do të përdorë, apo të bëjë të ditur tek të tretët, dhe as nuk do të bëhet shkak që Kompania të përdorë sekretin tregtar, apo informacionin konfidencial, të asnjë personi, apo subjekti tjetër.

KOMPANIA

PUNËKËRKUESI

Emri dhe mbiemri në germa shtypi dhe pozicioni

Emri dhe mbiemri në germa shtypi dhe pozicioni

Nënshkrimi

Nënshkrimi